Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Euro Abi shpk" të datës 06.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Euro Abi shpk" të datës 06.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Euro Abi shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 06.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – Inxhinieri konstruktiv dhe certifikimi i sigurisë

Kërkesa e cituar

2. Një (1) Inxhinier të diplomuar ose Bachelor të Ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, me së paku 5

(Pesë) vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i çertifikuar licencuar nga MPMS dhe MFPT, si Ekspert për Siguri dhe shëndet në punë me licencë B. (OIRK).

Kundërshtimi

Punimet kërkojnë organizim të sigurisë, përfshirë gërmimet dhe punën pranë trafikut. Dosja e lidh certifikimin e ekspertit të sigurisë me të njëjtin inxhinier konstruktiv dhe vendos edhe pragun prej pesë vitesh. Përgjegjësitë e sigurisë mund të mbulohen nga personi kompetent në ekip, sipas detyrimeve të zbatueshme. Kërkesa kumulative për të njëjtin person kufizon zgjedhjen e stafit.

Propozimi

Kërkojmë të pranohet inxhinier konstruktiv me diplomë dhe licencë të vlefshme të kategorisë që mbulon detyrat e caktuara. Për këtë pozitë të kërkohen vetëm diploma, CV-ja, referencat dhe licenca profesionale. Të hiqen kushtet dhe dëshmitë shtesë të kontestuara. Detyrat e posaçme të sigurisë të mbulohen në ekip sipas kërkesave të zbatueshme.

Pretendimi nr. 2 – Inxhinieri i gjeodezisë

Kërkesa e cituar

3. Një (1) Inxhinier të diplomuar ose Bachelor të Ndërtimtarisë - drejtimi Gjeodezi, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit. I licencuar nga AKK, licenca valide. ekspert i çertifikuar i GIS.

Kundërshtimi

Piketimi, kontrolli gjeometrik dhe dokumentimi i punimeve e arsyetojnë angazhimin e gjeodetit. Dorëzimi i të dhënave në formatin e kërkuar mund të kontrollohet si rezultat i punës. Certifikata GIS dhe certifikata e sigurisë e shtuar te Dëshmia 2 nuk janë të nevojshme si dëshmi individuale për këtë funksion. Dosja duhet ta dallojë licencimin për matjet ndërtimore nga licencimi për shërbime kadastrale.

Propozimi

Kërkojmë të pranohet inxhinier të gjeodezisë me diplomë dhe licencë profesionale të vlefshme për matjet ndërtimore. Për këtë pozitë të kërkohen vetëm diploma, CV-ja, referencat dhe licenca profesionale. Të hiqen kushtet dhe dëshmitë shtesë të kontestuara. Licenca kadastrale të lidhet me shërbim kadastral të identifikuar, nëse kërkohet një shërbim i tillë.

Pretendimi nr. 3 – Inxhinieri i elektroteknikës

Kërkesa e cituar

6. Një (1) - Inxhinier i dip. i elektroteknikës, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, të certifikuar si Auditor i Energjisë në Ndriçimin Publik, i cili ka menaxhuar së paku një (1) projekt të ndriçimit publik SMART, po ashtu te jetë i licencuar me kategorinë A nga (OIRK).

Kundërshtimi

Paramasa, te pozicionet 2,2,2 dhe 2,2,3 të fletës "Elektrika", përshkruan ndriçues me Dimming/DALI dhe NEMA socket. Nuk identifikohet furnizimi dhe vënia në funksion e një sistemi të plotë SMART me kontrollues dhe platformë të menaxhimit nga distanca. Këto punime nuk e arsyetojnë certifikimin e detyrueshëm si auditor, referencën për menaxhim të një projekti SMART dhe pragun shtesë prej pesë vitesh.

Propozimi

Kërkojmë të pranohet inxhinier të diplomuar të elektroteknikës me licencë profesionale të vlefshme të

kategorisë A. Për këtë pozitë të kërkohen vetëm diploma, CV-ja, referencat dhe licenca profesionale. Të hiqen kushtet dhe dëshmitë shtesë të kontestuara.

Pretendimi nr. 4 – Ekonomisti

Kërkesa e cituar

7. Një (1) Ekonomist me provoj pune 5 vite, të ketë provoj pune ne menaxhimin e energjisë elektrike në ndriçim publik smart. Ekonomist i Certifikuar në ESRx-Reforma e Subvencionimit të Energjisë. Gjithashtu te jete i certifikuar për Programim dhe Politika Financiare (FPP)

Kundërshtimi

Paramasa nuk identifikon punë që kërkon reformë të subvencionimit të energjisë ose programim të politikave financiare. Certifikimet ESRx dhe FPP dhe përvoja e posaçme në menaxhimin e energjisë për ndriçim SMART nuk lidhen me detyra të përcaktuara të ekonomistit në këtë kontratë.

Propozimi

Kërkojmë heqjen e certifikimeve ESRx dhe FPP dhe të kushtit për përvojë në ndriçim SMART. Nëse ruhet pozita e ekonomistit, kualifikimi dhe përvoja të dëshmohen me diplomë, CV dhe referenca për detyrat financiare që i caktohen.

Pretendimi nr. 5 – Raporti i kalkulimit fotometrik me ofertë

Kërkesa e cituar

Kërkesa 6. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë, së bashku me ofertën, raportin e kalkulimit fotometrik të përgatitur në softuerin DIALux ose ekuivalent për trupin ndriçues te ofruar, të nënshkruar nga një Auditor i Certifikuar për Ndriçim Publik dhe të vulosur nga Operatori Ekonomik. Raporti duhet të vërtetojë se ndriçuesi i ofertuar siguron përputhshmëri të plotë me parametrat fotometrik dhe kërkesat e projektit.

Dëshmia 6. Raporti i kalkulimit fotometrik (DIALux Evo ose ekuivalent), i nënshkruar nga Auditori i Certifikuar për Ndriçim Publik dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, ofertuesi duhet të paraqesë edhe skedarin burimor të projektit dhe skedarin fotometrik (IES LDT) të ndriçuesit të ofertuar për qëllime verifikimi.

Kundërshtimi

Pozicionet 2,2,2 dhe 2,2,3 në fletën "Elektrika" përshkruajnë ndriçuesit dhe veçoritë Dimming/DALI dhe NEMA socket. Në paramasën e publikuar nuk identifikohet një pozicion për furnizimin dhe vënien në punë të një sistemi të plotë SMART me kontrollues dhe platformë qendrore. Një kalkulim fotometrik mund të përdoret edhe për ndriçim të zakonshëm, por dosja duhet të shpjegojë pse kërkohet si kusht i detyrueshëm i ofertës, me nënshkrim të posaçëm të auditorit, për këtë fushëveprim.

Propozimi

Kërkojmë heqjen e Kërkesës 6 dhe Dëshmisë 6 për dorëzimin e raportit DIALux ose ekuivalent me ofertë. Përputhja e ndriçuesve me specifikimet të verifikohet me fletët teknike dhe të dhënat fotometrike të prodhuesit.

Pretendimi nr. 6 – Pajisja nr. 1 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 1

Buldozher, me peshë, min. 14 ton - max 16 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Punimet tokësore, poz. 1.3.1 dhe 1.4.4–1.4.8, e arsyetojnë shpërndarjen e materialit. Nevoja për buldozer mund të ekzistojë. Maksimumi 16 ton nuk arsyetohet vetëm nga sasitë.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet funksioni kur përfshihet në metodologji. Të përcaktohet kapaciteti dhe të lejohet makinë ekuivalente. Të hiqet kufiri maksimal i peshës pa kufizim të dokumentuar të terrenit. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 7 – Pajisja nr. 2 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 2

Ekskavator për germim, me peshë, min. 26 ton – max 30 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Gërmimi i rrugës është 17.896,18 m³ dhe ka demolime. Ekskavatori i madh ka lidhje të qartë. Nuk argumentohet që pajisja duhet të jetë patjetër 26–30 ton.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet kapacitet i përshtatshëm gërmimi/ngarkimi, thellësi dhe pajisje për demolim sipas nevojës. Të pranohen pesha ekuivalente që përmbushin punën. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 8 – Pajisja nr. 3 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 3

Ekskavator, me peshë, min. 20 ton – max. 26 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Rrjetet lejojnë fronte paralele dhe mund të kërkojnë ekskavator shtesë. Nevoja nuk kundërshtohet automatikisht, por duhet dalluar nga nr. 2 dhe 4.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të lidhet njësia shtesë me frontet dhe kapacitetin ditor. Të hiqet intervali i ngushtë 20–26 ton kur nuk ka arsye teknike të posaçme. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 9 – Pajisja nr. 4 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 4

Ekskavator, me zingjir, pllug dhe riper, me peshë, 23 ton – max. 25 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Formulimi "ekskavator ... Pllug dhe riper" është i paqartë. Funksioni mund të mbivendoset me buldozerin dhe ekskavatorët e tjerë. Kategoritë e dheut nuk provojnë vetvetiu këtë konfigurim specifik. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë nga lista e detyrueshme. Gërmimi dhe përpunimi i materialit të mbulohen me pajisjet e përshtatshme për terrenin.

Pretendimi nr. 10 – Pajisja nr. 5 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 5

Ekskavator, me peshë ,min. 5 ton – max. 8 ton Sasia e kërkuar: 2 copë

Kundërshtimi

Dy ekskavatorë të vegjël mund të punojnë në kanalet e ujit, kanalizimit dhe elektrikës. Nuk ka bazë të mjaftueshme për t'i quajtur të tepërt, por ka mbivendosje me nr. 6.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet pajisje e përshtatshme për gjerësinë, thellësinë dhe qasjen në kanale. Sasia dy të argumentohet me fronte paralele, pa kategori peshe të panevojshme. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 11 – Pajisja nr. 6 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 6

Ekskavator me zingjir gome, me peshë, min.4 ton – max. 5 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Zinxhirët prej gome mund të mbrojnë sipërfaqet ekzistuese, por nuk identifikohet segment që e bën këtë konfigurim të domosdoshëm krahas dy njësive nr. 5.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të lejohet ekskavator kompakt ose zgjidhje ekuivalente që mbron sipërfaqet. Njësia e tretë e vogël të kërkohet vetëm kur arsyetohet nga qasja dhe frontet. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 12 – Pajisja nr. 7 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 7

Sharre prerese hidrualike qe montohet ne eskavator me peshë max. 60 kg
Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Prerja vijore është 45 m, poz. 1.2.10. Ka edhe demolime. Nuk lidhet nevoja me shtojcë ekskavatori që peshon maksimum 60 kg.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet pajisje për materialin dhe thellësinë e prerjes. Të hiqen montimi dhe pesha si kufizime të detyrueshme kur puna kryhet me metoda ekuivalente. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 13 – Pajisja nr. 8 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 8

Kamion kiper me kapacitet min. 10 m3; - me librezë Sasia e kërkuar: 10 copë

Kundërshtimi
Gërmimet dhe furnizimi i shtresave janë të konsiderueshme. Deponia kërkohet minimum 15 km larg. Nuk ka bazë të fortë për heqjen e dhjetë kamionëve pa analizë të ciklit të transportit.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të arsyetohet numri me volum/ngarkesë, distancë, cikle dhe kërkesë ditore. Të pranohen kombinime kamionësh me kapacitet total të mjaftueshëm dhe ngarkesa të lejuara. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 14 – Pajisja nr. 9 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 9

Ngarkues min. me peshë, 20 ton - max. 24 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Ngarkimi i materialeve ka lidhje me shtresat dhe transportin. Nuk argumentohet pse kërkohen njëkohësisht katër ngarkues dhe kategori 20–24 ton.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të përcaktohen kapaciteti i kovës dhe prodhimtaria. Të mbahet kapaciteti i nevojshëm, duke lejuar kombinime ekuivalente dhe rishikuar numrin total. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 15 – Pajisja nr. 10 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 10

Ngarkues min. me peshë ,12 ton - max. 16 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Ka përdorim për furnizim/ngarkim, por funksioni mbivendoset me nr. 9 dhe ngarkuesit e vegjël. Një kategori e dytë peshe nuk provon domosdoshmëri.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet vetëm nëse ka front të veçantë ose kapacitet të pambuluar. Të hiqet detyrimi për kategorinë 12–16 ton dhe të pranohen kapacitete ekuivalente. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 16 – Pajisja nr. 11 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 11

Ngarkues me luge dhe fshesë min me peshë, min 6.5 ton - max 8.5 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Pastrimi nevojitet për shtresat dhe asfaltimin. Ka mbivendosje me nr. 12, 26 dhe 29. Numri i mjeteve të pastrimit nuk arsyetohet.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet funksioni i pastrimit dhe ngarkimit, duke lejuar shtojca të ndërrueshme. Të shmanget njësia e veçantë kur funksioni mbulohet nga mjete të tjera. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 17 – Pajisja nr. 12 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 12

Ngarkues me luge ngarkuese me fshesë dhe pirun, me peshë, min 5 ton - max 6 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Luga, fshesa dhe piruni mund të shërbejnë, por kombinimi në një mjet 5–6 ton nuk lidhet me ngarkesa konkrete. Mbivendoset me nr. 11.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të përcaktohen funksionet dhe kapaciteti ngritës. Të lejohet mbulimi me një ose disa mjete ekuivalente. Të hiqet konfigurimi dhe intervali i ngushtë detyrues. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 18 – Pajisja nr. 13 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 13

Makine-Paisje per shtrimin e Bankinave dhe Rigollave me GPS dhe nivelisues automatik që montohet ne ngarkues me peshë min. 1 ton – max. 1.5 ton

Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Poz. 1.3.3 ka bankina me tampon. Nuk identifikohet punim rigollash që kërkon këtë shtojcë GPS. Bankinat kanë edhe mospërputhje sasie në formulë. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë nga Aneksi 8. Bankinat të realizohen me mjete që sigurojnë profilin dhe ngjeshjen e kërkuar.

Pretendimi nr. 19 – Pajisja nr. 14 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 14

Kamion me rimorkio apo gjysmërimorkio për transport të makinerisë me peshë të ngarkesës min 38 ton; me librezë

Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Transporti i makinerive të rënda ka lidhje me mobilizimin. Kapaciteti 38 ton mund të shërbejë për makinat e listuara. Nuk identifikohet arsye për heqje të funksionit.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të lejohet mjet ose marrëveshje shërbimi për transport të sigurt të makinerisë më të rëndë të ofertuar, me dokumentacionin dhe kapacitetin e lejuar. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 20 – Pajisja nr. 15 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 15

Makine per sheshimin dhe nivelizimin e rrugëve min. 4 ton – max. 6 ton Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Nivelimi është i nevojshëm, por ka grejder, buldozer dhe ngarkues. Nuk identifikohet punim që kërkon patjetër një makinë tjetër 4–6 ton. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht kërkesa për makinën shtesë 4–6 ton. Nivelimi të mbulohet me grejder ose pajisje ekuivalente sipas metodologjisë.

Pretendimi nr. 21 – Pajisja nr. 16 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 16

Grejder mbi 16 ton; - me librezë Sasia e
kërkuar: 1 copë **Kundërshtimi**

Grejderi ka lidhje të drejtpërdrejtë me profilimin dhe poz. 1.4.8, i cili e përmend. Pesha mbi 16 ton nuk lidhet me tolerancë ose produktivitet të përcaktuar.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet grejder me gjerësi, fuqi dhe nivelim të përshtatshëm për projektin. Të lejohet ekuivalencë funksionale në vend të kushtit të vetëm të peshës. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 22 – Pajisja nr. 17 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 17

Damper mbi 3 ton; - me librezë Sasia e
kërkuar: 1 copë **Kundërshtimi**

Damperi mund të përdoret për transport lokal në zona të ngushta. Paramasa nuk përcakton qasje që e bën të domosdoshëm krahas kamionëve dhe ngarkuesve. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi
Të hiqet tërësisht damperi si njësi e veçantë e detyrueshme. Transporti lokal të mbulohet nga mjetet e përshtatshme të kontraktorit.

Pretendimi nr. 23 – Pajisja nr. 18 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 18

Cilinder Teledirixhues max 2 ton Sasia
e kërkuar: 1 copë **Kundërshtimi**

Ngjeshja në kanale ka lidhje me rrjetet. Teledirigjimi mund të ndihmojë sigurinë, por nuk argumentohet pse është e vetmja zgjidhje e lejuar, krahas nr. 42–43.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet pajisje ngjeshjeje për kanale me gjerësi dhe siguri të përshtatshme, duke lejuar komandim nga distanca ose zgjidhje ekuivalente. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 24 – Pajisja nr. 19 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 19

Cilinder me vemza për ngjeshje me peshë min. 21.5 ton – max. 22.5 ton Sasia
e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Kërkohet kategori shumë e ngushtë 21,5–22,5 ton. Nuk lidhet me llojin e materialit dhe rezultatin e kërkuar. Ka kategori të tjera të afërta në listë.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të rishikohet nevoja për cilindër me këtë konfigurim. Të kërkohen parametra ngjeshjeje dhe plan punimi, jo interval 1-tonësh i peshës. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 25 – Pajisja nr. 20 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 20

Cilinder me vemza për ngjeshje, vibratorë me peshë min. 15.5 ton – max. 17.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Funksioni mbivendoset pjesërisht me nr. 19 dhe 21. Nuk ka plan që arsyeton numrin e kategorive të rënda dhe konfigurimin për materialet e projektit.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të lidhet lloji i cilindrit me materialet dhe trashësitë e shtresave. Të hiqet njësia e veçantë kur funksioni mbulohet nga pajisje ekuivalente. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 26 – Pajisja nr. 21 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 21

Cilindër vibrues për ngjeshje me peshë min. 17 ton – max. 19 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Ngjeshja vibruese ka lidhje me shtresat, por një cilindër tjetër 17–19 ton kërkon arsyetim krahas nr. 19–20 dhe 22.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet kapaciteti vibrues i nevojshëm. Numri të argumentohet me sipërfaqet dhe frontet. Të lejohet pajisje ekuivalente pa interval maksimal të pajustifikuar. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 27 – Pajisja nr. 22 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 22

Cilindër vibrues për ngjeshje me peshë min. 10 ton – max. 12 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Mund të shërbejë për shtresa dhe zona të ndryshme, por domosdoshmëria e një njësie të veçantë 10–12 ton nuk del nga paramasa.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të lidhet me front ose zonë të përcaktuar. Të lejohet mbulimi nga komplet i arsyetuar ngjeshjeje dhe të hiqet detyrimi për kategori peshe të veçantë. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 28 – Pajisja nr. 23 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 23

Cilindër jo vibrues me peshë min. 11 ton – max. 13 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Poz. 1.4.8 kërkon ngjeshje pa vibrim, prandaj funksioni është i arsyetuar. Nuk provohet pse duhet makinë vetëm jovibruese dhe intervali 11–13 ton.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet mundësia e punës statike. Të pranohen edhe cilindra me vibrim të çaktivizueshëm kur plotësojnë kushtet teknike dhe cilësinë e kërkuar. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 29 – Pajisja nr. 24 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 24

Cilindër jo vibrues me peshë min. 17 ton – max. 19 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Funksioni statik mbivendoset me nr. 23. Paramasa nuk provon nevojën për dy cilindra jovibrues të veçantë në pesha të ndryshme. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë si cilindër i dytë statik i detyrueshëm. Funksioni statik të mbulohet me kompletin e ngjeshjes.

Pretendimi nr. 30 – Pajisja nr. 25 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 25

Gjysme rimorkio speciale për sinjalizim; Sasia e
kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Menaxhimi i trafikut lidhet me poz. 1.2.3 dhe 1.2.8. Por nuk përcaktohet çfarë pajisjesh duhet të ketë gjysmërimorkioja dhe pse nuk pranohen zgjidhje të tjera sinjalizimi.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohen pajisjet e sinjalizimit të përkohshëm sipas planit të trafikut. Të lejohet rimorkio ose sistem ekuivalent me funksionin e përcaktuar. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 31 – Pajisja nr. 26 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 26

Gjysme rimorkio per pastrimin e rrugeve me dy pompa me presion min. 220 bar; - me librezë Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Pastrimi është i nevojshëm, por dy pompa 220 bar nuk lidhen me punim të veçantë. Ka disa mjete me fshesë në listë.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet rezultat dhe kapacitet pastrimi, pa konfigurim detyrimisht gjysmërimorkio me dy pompa, në mungesë të arsyetimit. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 32 – Pajisja nr. 27 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 27

Gjysme rimorkio kiper me kran me gjatesi min 6m, me pesh max 1.2 ton; - me librezë Sasia
e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Ka ngritje elementesh dhe shtylla, por përshkrimi nuk sqaron nëse "max 1.2 ton" është peshë e mjetit apo ngarkesë. Gjatësia 6 m nuk përcakton kapacitetin në rreze pune.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të sqarohet pesha dhe të jepet kapaciteti ngritës në rrezen e nevojshme. Të pranohet kamion me kran, vinç ose mjet ekuivalent që mbulon elementet reale. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 33 – Pajisja nr. 28 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 28

Cisternë (Autobotë) për karburante; - me librezë Sasia
e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Furnizimi i makinerive me karburant është nevojë organizative, por nuk është produkt i veçantë i

kontratës që provon domosdoshmëri për autobotë të dedikuar. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht kërkesa për autobotë të dedikuar. Furnizimi me karburant të sigurohet sipas organizimit të kontraktorit.

Pretendimi nr. 34 – Pajisja nr. 29 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 29

Kamion me fshisë që posedon Spërkatës për emulusion; - me librezë Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Fshesa dhe spërkatja me emulsion lidhen me asfaltimin. Nuk arsyetohet që të dy funksionet të jenë domosdoshmërisht në të njëjtin kamion.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahen funksionet e pastrimit dhe spërkatjes së kalibruar, duke lejuar mjete të veçanta ose të kombinuara. Të shmanget dyfishimi me nr. 11–12, 26 dhe 31. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 35 – Pajisja nr. 30 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 30

Makine-Paisje montuese për pastrimin e pahive elastike dhe shejave në komunikacion max 400 kg; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Nuk identifikohet pozicion për pastrimin e pahive elastike. Shenjat e reja nuk e arsyetojnë një shtojcë të posaçme 400 kg. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë nga Aneksi 8, meqë në paramasën e shqyrtuar nuk identifikohet punimi i pastrimit të pahive elastike.

Pretendimi nr. 36 – Pajisja nr. 31 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 31

Makine per shperndarjen e Bitolitit me peshë 400 kg- max 600 kg; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

"Bitoliti" nuk lidhet me material dhe punim të qartë. Ekziston spërkatësi i emulsionit nr. 29 dhe mund të ketë mbivendosje. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë i veçantë nga Aneksi 8. Spërkatja të mbulohet me pajisje të përshtatshme për materialin e përcaktuar në paramasë.

Pretendimi nr. 37 – Pajisja nr. 32 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 32

Gerryese e asfalltit,me peshë ,min 16 ton – max 18 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Poz. 1.2.11 ka vetëm 600 m² asfalt për largim me trashësi 15 cm. Nuk provohet nevoja për dy gërryese dhe për njësi 16–18 ton.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të hiqet kërkimi kumulativ i dy gërryeseve. Të lejohet metodë/pajisje e përshtatshme. Nëse kërkohet frezim, të përcaktohet kapaciteti i nevojshëm. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 38 – Pajisja nr. 33 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 33

Gerryese e asfalltit, me peshë, min 6 ton – max 8 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Ka të njëjtin vëllim të kufizuar prej 600 m². Nuk identifikohet front ose qasje që kërkon kategori të dytë 6–8 ton. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë si gërryese e dytë e detyrueshme. Për pozicionin 1.2.11 të pranohet metoda e përshtatshme për largimin e asfaltit.

Pretendimi nr. 39 – Pajisja nr. 34 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 34

Finisher per shtrirjen e asfalltit, me peshë min 20.5 ton – max 22.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Rruga ka 15.498 m² asfaltim kryesor me tri shtresa. Finisher kryesor nevojitet, por kjo nuk provon tre finisherë të mëdhenj me pesha të ndryshme.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet finisher kryesor me gjerësi dhe kapacitet të përshtatshëm. Të hiqet intervali 20,5–22,5 ton dhe të arsyetohet çdo finisher tjetër me fronte simultane. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 40 – Pajisja nr. 35 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 35

Finisher per shtrirjen e asfalltit, me peshë min 18.5 ton – max 19.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Funksioni mbivendoset me nr. 34 dhe 36. Nuk identifikohet fazë që kërkon patjetër njësi 18,5–19,5 ton. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë si kategori e veçantë e finisherit. Kapaciteti shtesë të kërkohet vetëm nëse frontet e punës e arsyetojnë.

Pretendimi nr. 41 – Pajisja nr. 36 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 36

Finisher per shtrirjen e asfalltit, me peshë min 15.5 ton – max 17.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Është finisheri i tretë i madh. Numri dhe pesha 15,5–17,5 ton nuk lidhen me një front të identifikuar në paramasë. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë si finisher i tretë i madh i detyrueshëm. Të kërkohet kapaciteti total i nevojshëm i shtrimit.

Pretendimi nr. 42 – Pajisja nr. 37 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 37

Finisher per shtrirjen e asfalltit, me peshë min 4.5 ton – max 6.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Shiritat e biçikletave kanë gjerësi të përdorur në llogaritje 1,6 m dhe 2.755,20 m² për shtresë. Pajisja për shtrim të ngushtë ka lidhje me këto punë.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet aftësia për shtrim në gjerësi të ngushtë, duke pranuar finisher me konfigurim të përshtatshëm. Të hiqet kufiri 4,5–6,5 ton si kriter i vetëm. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 43 – Pajisja nr. 38 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 38

Cilindra per shtrirjen e asfalltit hekur-hekur me peshë, min 7.5 ton – max 8.5 ton; Sasia e kërkuar: 2 copë

Kundërshtimi

Dy cilindra tandem mund të shërbejnë asfaltimin, por sasia duhet parë me frontet dhe të gjithë kompletin prej gjashtë cilindrash asfalti. Intervali 7,5–8,5 ton nuk arsyetohet veçmas.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të përcaktohet komplet ngjeshjeje sipas ritmit të shtrimit dhe densitetit të kërkuar. Numri dy të argumentohet. Të pranohen parametra dhe pesha ekuivalente. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 44 – Pajisja nr. 39 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 39

Cilindra per shtrirjen e asfalltit gome-hekur me peshë, min 7.5 ton – max 8.5 ton;
Sasia e kërkuar: 2 copë

Kundërshtimi
Kërkohen dy njësi të tjera gome-hekur krahas dy tandemëve dhe cilindrave të vegjël. Nuk provohet përdorimi i njëkohshëm i të gjashtëve.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të arsyetohet konfigurimi me plan ngjeshjeje për përzierjet e asfaltit. Të pranohen kombinime ekuivalente pa imponuar dy njësi dhe interval të ngushtë peshe pa llogaritje. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 45 – Pajisja nr. 40 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 40

Cilinder per shtrirjen e asfalltit hekur-hekur me peshë, min 4 ton – max 5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Cilindri i vogël mund të nevojitet për shiritat dhe hapësirat e ngushta. Nuk provohet detyrimi për të dy cilindrat e vegjël nr. 40 dhe 41.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohet kapacitet i përshtatshëm për gjerësitë e ngushta dhe materialin. Të lejohet mbulim me kompletin e ngjeshjes pa kategori peshe të panevojshme. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 46 – Pajisja nr. 41 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar
Nr. 41

Cilinder per shtrirjen e asfalltit gome hekur me peshë, min 3 ton – max 4 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi
Funksioni pjesërisht mbivendoset me nr. 40. Nevoja për konfigurim tjetër gome-hekur 3–4 ton nuk shpjegohet me plan teknik. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi
Të hiqet tërësisht ky zë si njësi shtesë e detyrueshme. Ngjeshja në sipërfaqet e ngushta të mbulohet me kompletin e përshtatshëm.

Pretendimi nr. 47 – Pajisja nr. 42 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 42

Cilindra vibrues me peshë max. 600 kg; Sasia e kërkuar: 2 copë

Kundërshtimi

Kanale dhe trotuare kërkojnë pajisje të vogla ngjeshjeje. Dy njësi mund të justifikohen me fronte paralele, por maksimumi 600 kg nuk përshkruan gjerësinë dhe performancën.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahen pajisje kompakte të përshtatshme për kanalet/trotuaret. Të përcaktohet funksioni dhe kapaciteti, duke lejuar pllaka vibruese ose rul ekuivalent kur teknikisht i përshtatshëm. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 48 – Pajisja nr. 43 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 43

Cilinder-Rul me shtytes per shtrimin e rrugeve me xhemba dhe vibrues min, 400 kg- max 600 kg; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Ka mbivendosje me pajisjet nr. 18 dhe 42. Formulimi nuk është i qartë për sipërfaqen dhe materialin ku kërkohen xhembat. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht ky zë si njësi e veçantë. Ngjeshja e kanaleve të mbulohet me pajisje të përshtatshme për materialin dhe hapësirën.

Pretendimi nr. 49 – Pajisja nr. 44 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 44

Makinë për vizatimin e vijave në asfallt peshë, min 2 ton – max 2.5 ton; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Pozicionet 1.7 kërkojnë vijëzim, por pesha 2–2,5 ton nuk tregon përputhjen me materialin dykomponentësh, trashësinë dhe gjerësinë e aplikimit.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të mbahet pajisje vijëzimi e përshtatshme për materialin dhe dimensionet e projektit. Të hiqet intervali i peshës dhe të specifikohen parametrat e aplikimit. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 50 – Pajisja nr. 44, zëri i dytë e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 44 – zëri i dytë me këtë numër

Kove për perzirjen e betonit me peshë min. 300kg – max. 600kg; Sasia e kërkuar: 1 copë

Kundërshtimi

Betoni nevojitet për puseta, baza dhe vendosje skajorësh. Furnizimi mund të mbulohet nga baza e betonit. Nuk identifikohet detyrim për përzierje me këtë kovë të posaçme. Kufiri ose konfigurimi i përcaktuar e bën të detyrueshme një pajisje për të cilën dosja nuk tregon nevojë të veçantë.

Propozimi

Të hiqet tërësisht kova e posaçme nga lista e detyrueshme. Betoni të sigurohet sipas klasës dhe cilësisë së kërkuar në projekt.

Pretendimi nr. 51 – Pajisja nr. 45 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 45

Kamioneta Doublekabine me peshë bartëse ngarkeses lejuar min 1.2 ton – max 1.4 ton; me librezë Sasia e kërkuar: 3 copë

Kundërshtimi

Transporti i ekipeve është i arsyeshëm. Numri tre dhe sidomos kufiri maksimal 1,4 ton nuk lidhen me kërkesë konkrete të projektit.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të përcaktohet transporti minimal i ekipeve/materialeve dhe të pranohet kapacitet ekuivalent ose më i madh. Të hiqet maksimumi i ngarkesës pa kufizim të dokumentuar. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 52 – Pajisja nr. 46 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 46

Kamioneta Kiper me peshë të barabart ose më të madhe se 5 ton;
Sasia e kërkuar: 3 copë

Kundërshtimi

Ka transport të vogël brenda punishtes, por tre kamioneta kiper shtohen mbi dhjetë kamionë dhe damperin. "Peshë" nuk sqaron masën totale apo kapacitetin bartës.

Propozimi

Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të sqarohet madhësia e referuar dhe nevoja e numrit tre. Të lejohet kombinim mjetesh që mbulon transportin lokal, pa kërkim të panevojshëm të njësive të veçanta. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Pretendimi nr. 53 – Pajisja nr. 47 e Aneksit 8

Kërkesa e cituar

Nr. 47

GPS për matje gjeodezike të tereneve;
Sasia e kërkuar: 2 copë **Kundërshtimi**

Matjet e vazhdueshme kanë lidhje të drejtpërdrejtë. Dy GPS mund të nevojiten për ekipe paralele, por nuk përcaktohen saktësia dhe përdorimi i dy njësive.

Propozimi
Kërkojmë ndryshimin e këtij zëri. Të kërkohen instrumente me saktësi të përshtatshme për piketim dhe kontroll. Numri dy të lidhet me ekipet. Të pranohen GNSS/RTK ose instrumente të tjera sipas matjes, jo vetëm emërtimi GPS. Çdo kufi, konfigurim ose numër i detyrueshëm të mbështetet në punimet dhe kapacitetin real të kërkuar. Të pranohen zgjidhje ekuivalente.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net